

## SI ZBAVITEN.

Të mëdhenj e të vegjël lozin “kësulash”, dhe kjo munt të lohet brenda n’ odë ose përjashta në shesh ke obori i kishës. Pra, për këtë gjë marin disa kësule edhe i shtrajnë për dhë. Pastaj ndahen më dy “lagje” (anë) dhe njëra nga ato fsheh nënë kësulet ose shputat një unazë, të cilën lagja kundërshtarë përpiqet t’ a giejë gjer më tri herë. Në qoftë se s’e gjen, partia tjetër e fsheh unazën edhe kundërshtarët përpiqen prapë t’ ja u marin. Kjo gjë vazhdon gjer sa njëra anë të bëjë një qint pika më parë. Po të ndodhen përjashta, grupi fitimtar bën një vark edhe ja marin këngës edhe valles dyke u tallur me humbësit. Kur lozin valle nuk venë për qark, po hidhen më një vent dyke qënë të zënë krahë më krahë.

Një lloj me lodrën e sipërme është edhe ajo që quhet “fixhanash”. Në këtë rast përdorin filxhanët e kafesë edhe jo shputat ose kësulet.

Në disa vënde kemi lojtur me kartra edhe pas darke. Lodrës që një prej Korçe i thotë konçinë, në Mirditë e quajnë “spathish”. Fandin atje e kanë pagëzuar xhandar edhe, si pas mënyrës së tyre, munt të mbledhë të gjithë